



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		02/10/2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
06-	06010	48997	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLLOGOCIT DRENASIT
DREJTORIA KOMUNALE PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtorja për Shëndetësi, duke u bazuar në statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, neni 11.7 dhe neni 12 pika 6, me qëllim të themelimit të Këshillit të Pacientëve me datë 15.09.2023 e publikon këtë:

FTESË PUBLIKE

“PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË PACIENTËVE”

Me hyrjen në fuqi të statudit të QKMF – së, përkatësisht nenin 12.6, është paraparë edhe themelimi i Këshillit të Pacientëve. Me qëllim të zbatimit të këtij neni, Drejtorja Komunale për Shëndetësi fton të gjithë qytetarët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij Këshilli.

Këshilli i Pacientëve do të ketë mandat 3 vjeçar.

Propozimet duhet të dorëzohen nga data 02.10.2023 deri me datë 17.10.2023 në e-mailin Lumturije.Kiqina@rks-gov.net ose në zyrën e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Të gjitha propozimet e pranuar pas këtij afati, nuk do të merren parasysh nga komisioni.

Dokumentet e kërkuara:

1. Aplikacioni për të qenë anëtar i Këshillit;
2. Kopja e Letërnjoftimit;
3. Një letër motivuese se pse dëshironi të jeni anëtar i Këshillit.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

znj. Lumturije Gjosha Klapan





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLLOGOCIT DRENASIT
DREJTORIA KOMUNALE PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Termet e Referencës:

Në Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare është paraparë edhe themelimi i Këshillit të Pacientëve si një mekanizëm formal i angazhimit të qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Për këtë qëllim, DSHMS ka hapur thirrje publike për të gjithë qytetarët e Komunës së Gllugocit që janë të interesuar të jenë pjesë e Këshillit të Pacientëve.

Qëllimi i Këshillit të Pacientëve është që të shërbej si një mekanizëm formal për përfshirjen e pacientëve në vendimmarrje në mënyrë që të punojnë së bashku me institucionet dhe stafin shëndetësor për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe komunitetin.

Objektivat e Këshillit të Pacientëve do të jenë:

- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi shëndetin e tyre dhe shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore;
- Identifikimi i problemeve të pacientëve;
- Ndërtimi i besimit ndërmjet Stafit Shëndetësor dhe Pacientëve;
- Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të gjithë pacientëve;
- Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në fushën e shëndetësisë.

Fushëveprimi i këshillit të pacientëve shtrihet brenda teritorit të Komunës së Gllugocit dhe merret me përfaqësimin e interesave dhe brengave të pacientëve brenda kësaj komune;

Antarësimi në Këshill të Pacientëve është i hapur. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Gllugocit të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, nuk janë anëtar të ndonjë partie politike, të cilët nuk ofrojnë shërbime shëndetësore ose farmaceutike, nuk janë të punësuar në institucionet publike të kësaj komune dhe nuk kanë të kaluar kriminale.

Këshilli do të mandat 3 vjeçar me mundësi vazhdimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLLOGOVCIT DRENASIT
DREJTORIA KOMUNALE PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

FORMA E APLIKIMIT:

EMRI: _____

MBIEMRI: _____

ADRESA: _____

DATËLINDJA: _____

SHKOLLIMI: _____

PROFESIONI _____

KONTAKTI:

TEL: _____

EMAIL: _____

A KENI QENË NË TË KALUARËN:

- a) PACIENT
- b) PËRCJELLËS I PACIENTIT
- c) ASNJËRA NGA KËTO

Nënshkrimi i aplikuesit:

Data:



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLLOGOVCIT DRENASIT
DREJTORIA KOMUNALE PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
